



MULTIKULTURA



...towards common values!

- *different colors*
- *different nations*
- *different cultures*
inside one NGO
Multikultura

MULTIKULTURA

për më tepër informacion rreth nesh kliko:
www.multikultura.org.mk

ngjyra të ndryshme
nacionalitete të ndryshme
kultura të ndryshme
brenda një OJQ-je
MULTIKULTURA



Editorial

Përmbajtja:

Anti-diskriminimi.....	4
Anti-korrupsioni.....	6
Dita e dallimeve.....	8
Rinia e udhëheq ardhmërinë.....	10



Multikultura është organizatë joqeveritare, misioni i së cilës është ndërtimi i një shoqërie demokratike përmes tolerancës së përshtatshme dhe bashkëpunimit ndëretnik, duke krijuar kushte të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve kulturore të të rinjve në vend.



Multikultura publikon këtë broshurë kushtuar temave të caktuara, të bazuara në kërkime dhe analiza. Shkrimet kryesisht ndërlidhen me probleme preokupuese për të rinjtë. Broshura është rezultat i entuziazmit, kreativitetit dhe përpjekjeve të stafit dhe një numri të madh të vullnetarëve tanë të organizatës, si dhe bashkëpunimit dhe mbështetjes së donatorëve të projekteve të përbashkëta. Qëllimi i kësaj broshure është të ndajmë dhe shkëmbejmë idetë dhe praktikatat e anëtarëve tanë, me ju lexues të nderuar.

Vullnet Zenki

Drejtor Ekzekutiv

Broshurë e OJQ Multikultura Tetovë

Redaksia:

Arlinda Mazllami, Maja Petrovska, Leonora Rexhepi, Arlind Qamili, Selima Shaqiri

Dizajni:

Fisnik Shabani

www.multikultura.org.mk

info@multikultura.org.mk

TË GJITHA QENIET NJERËZORE LINDIN TË BARABARTA

Provoni të mendoni për ndonjë person, të cilin ju e njihni dhe i cili gjatë gjithë jetës së tij, nuk ka qenë ndonjëherë subjekt i ndonjë forme të diskriminimit! Do ta shihni se nuk do të mund të gjeni asnjë të tillë!

Që nga fillimi i njerëzimit, diskriminimi, qoftë në një formë, qoftë në tjetrën ka paraqitur problem. Diskriminimi ndodh ndaj fëmijëve, femrave të cilat trajtohen si qenie njerëzore më pak të vlefshme, njerëzve të infektuar me HIV/AIDS, ndaj atyre që kanë të meta psikike dhe fizike, si dhe kundër atyre me orientime të tjera seksuale. Kjo shfaqet madje edhe në fjalorin tonë të përditshëm, përmes së cilit ndonjëherë, me qëllim ose pa qëllim e veçojmë veten nga të tjerët. Diskriminimi shfaqet në aq shumë forma, sa që mund të supozojmë se secili në njëfarë forme dhe sasi ka qenë i prekur nga diskriminimi.

Diskriminimi i romëve, popull i cili është lënë anash, paraqet një ndër problemet më serioze dhe më të fshehta të të drejtave të njeriut në Evropë. Duke qenë se gjatë pjesës më të madhe të historisë së tyre kanë qenë nomadë, romët në disa shtete zakonisht janë detyruar të asimilohen, në disa vende është ndaluar përdorimi i gjuhës së tyre dhe prindërve u janë marrë fëmijët nga përkujdesi. Sot, bashkësitë e romëve ende përjetojnë diskriminim në shumë sfera të jetës, përfshirë punësimin, arsimimin, strehimin, qasjen në shërbimet shëndetësore, lirinë e të shprehurit të fjalës.



Parimi sipas të cilit të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejta të barabarta dhe duhet të trajtohen njësoj, paraqet bazën e kuptimit të të drejtave të njeriut dhe rrjedh nga dinjiteti i barabartë njerëzor i çdo individ. Mirëpo, kjo e drejtë natyrore e barazisë, qoftë tani apo në të kaluarën, asnjëherë nuk u është ofruar të gjitha qenieve njerëzore në mënyrë të plotë.

Le ta përkujtojmë çka është diskriminimi...

-Diskriminimi është një dallim, mospërfillje, trajtim jo i barabartë i njerëzve për shkak të racës ose prejardhjes etnike të tyre, religjionit ose botëkuptimit, një të metë, moshës ose identitetit seksual të tyre.

Diskriminimi ndodh kur grupeve të caktuara që nuk kanë ndikim të madh, nuk u jepen të drejta të barabarta, si pjesës tjetër të shoqërisë. Diskriminimi mund të paraqitet në forma të ndryshme, e poashtu mund të kuptohet edhe në mënyra të ndryshme.

E vërteta është se çdo njeri në ndonjë formë ka hasur në diskriminim, sepse vetë kultura përbëhet nga forma të ndryshme të interpretimi të gjërave.



Llojet e diskriminimit:

1. Diskriminimi Direkt, kur dikush trajtohet me më pak favor në baza racore.
2. Diskriminimi Indirekt, kur rregullat dhe kushtet aplikohen pa arsye të vlefshme dhe kanë efekt të keq në personat nga racat e tyre.

Kërkimet tona kanë nxjerrë në pah se një diskriminim i gjërë ekziston tek ne. Format tradicionale të diskriminimit bazuar në gjini, racë, origjinë etnike, besim fetar dhe moshë, ekzistojnë veçanërisht tek ne, në një shtet multietnik.

Gjatë kërkimeve tona, disa nga pyetjet më interesante ishin si vijojnë: "A keni qenë të diskriminuar në baza etnike në punë?", dhe më interesante ishte përgjigja ku 56% të të anketuarve nuk kishin qenë të diskriminuar, e nga ana tjetër vetëm 6% prej tyre kishin qenë pre e ndonjë forme të diskriminimit.

Pyetjes tjetër, e cila thotë "Cilat janë arsyet sipas jush për diskriminim në baza etnikë?", arsyet politike zënë përqindjen më të madhe 68%, pastaj vijjnë arsyet shoqërore me 17%, arsyet ekonomike 8%, dhe në 7% e ngelur bëjnë pjesë arsye tjera të ndryshme.

Por sot, vërejmë edhe forma të reja të lindura të diskriminimit, që e komplikojnë më shumë çështjen, e ato bazohen në orientimin seksual, paafësitë, bindjet politike, cilësitë gjenetike dhe mënyra e jetesës.

Mendoj se jetojmë në shekullin e informatikës dhe në kohën kur shkencat dhe teknologjia po zhvillohen me një tempo marramendëse. Ne nuk kemi kohë më të mendojmë dhe diskutojmë se a duhet ose jo shamia apo një kryq i vendosur në qafe. Kush është ai që në këtë shekull do t'ia mohojë dikujt arsimimin vetëm pse mban një shami në kokë, kujt i konvenon që duke marrë për alibi shaminë, të leje muslimanet analfabete? Pse ndodh kjo në këtë shtet të deklaruar demokratik. Pse Muslimanet doni ti identifikoni në një shkollë të posaçme (medrese). Kush ka frikë nga shamia, mjekra e kryqi?! Ironike!

Sfida e vërtetë nuk është mbrojtja ose penalizimi, por parandalimi i diskriminimit, që do të thotë të ndalohen aktet diskriminuese para se të ndodhin. Prandaj, është e domosdoshme të trajtohen besimet, qëndrimet, veprimet dhe sjelljet tjera. Kjo detyrë e vështirë mund të arrihet vetëm përmes arsimimit institucional për të drejtat e njeriut, informimit lokal përmes qasjes poshtë-lart dhe pjesëmarrjes së plotë të autoriteteve vendore në bashkëpunim me pjesëtarët e tjerë relevant joshitetëror.

Është e drejtë themlore e njeriut të mos diskriminohet...

ANTI-KORRUPSIONI

Skandalet që kanë të bëjnë me korrupsionin e kanë rënduar shumë demokracinë në vend. E dijmë që shoqëria jonë për decaen të tëra ka jetuar në një sistem totalitar dhe jo transparent, andaj, më duket sikur demokracia është kuptuar si formë e përshtatshme e përfitimit të shpejtë dhe shumë të lehtë nga paratë publike.

Ne konsiderohemi një vend i varfër. Shkalla e papunësisë çdo ditë e më shumë rritet. E përkundër shkallës së lartë të papunësisë dhe varfërisë, po rritet edhe korrupsioni i institucioneve publike. Pra, po përfitohet nga paratë tona si tatimpagues, njerëzit po varfërohen gjithnjë e më shumë, e ndërsa nga ana tjetër po dobësohen institucionet demokratike.

Si mund ta definojmë korrupsionin?

Korrupsioni nënkupton çdo shkelje të detyrës së personave zyrtarë ose përgjegjës në subjektet juridike, për të realizuar një përfitim material ose jo material, për të cilin nuk ekziston e drejta e bazuar në ligj.



Problemi i korrupsionit është problem global. Ai lulëzon sot në errësirën e regjimeve totalitare, autoritare dhe diktatoriale, por në masë më të reduktuar edhe në mjedise demokratike, pluralizmi, liri shprehjeje e sigurie individuale.

Kjo nuk do të thotë se ne, si shoqëri demokratike i shpëtojmë fenomenit të korrupsionit. E vetmja përparësi e jona në këtë aspekt është e drejta për t'ë kritikuar, demaskuar dhe luftuar dikë, pa frikë se pushteti do të merr masa ndaj nesh.

Ekzistojnë dy forma të paraqitjes së korrupsionit, edhe atë:

1. Forma aktive, ku bëjnë pjesë kërkimi, oferta dhe premtimi i një përfitimi, rryshfeti, dobie ose të hollash.
2. Forma pasive, ku pranimi i përfitimit, rryshfetit, dobisë ose të hollave bëhet pa e kërkuar atë.

Korrupsioni në Maqedoni nuk paraqitet si dukuri vetëm në institucionet publike. Përmasat e përhapjes së tij janë bërë problem shumë serioz kohëve të fundit për shoqërinë.

Të marrim shembullin kur dikush konkurren në një vend pune. Duhet të hulumtohet në çdo mënyrë për të gjetur një lidhje, dikë që e njohish, i cili do të mund të të ndihmonte për të depërtuar në atë vend pune.

Ose të marrim rastin tjetër, për të të kryer dikush një punë të caktuar, qytetari, si pa të keq, i jep atij të holla. Kjo prirje kohëve të fundit, është shumë e theksuar në jetën tonë të përditshme. Mendoj se kjo ka të bëjë edhe me kulturën tonë të edukimit. Pra, kultura e dhënies është pothuajse po aq e lartë sa ajo marrjes.



Si bëhet matja e korrupsionit?

Shkalla e korrupsionit vlerësohet nëpërmjet të dhënave të drejtpërdrejta. Të dhënat më të besueshme për korrupsion janë të dhënat nga statistikat policore, mirëpo meqë organet shtetërore në vendin tonë vështirë japin informata të tilla (ndoshta pse edhe ato janë pjesë e korrupsionit, apo ndoshta për shkak të pasqyrimit të nivelit të tyre të cilësisë), prandaj ne vendosëm të zhvillojmë metodë tjetër për të matur shkallën e korrupsionit.

Për këtë arsye, që të arrijmë rezultatin për ekzistencën e korrupsionit brenda vendit tonë, ne përdorëm anketën si një nga metodat e hulumtimit. Pjesa më e madhe e të anketuarve ishin nxënës të shkollave të mesme në komunën e Tetovës dhe të Gostivarit, duke mos i lënë anash edhe grupmoshat më të mëdhaja, ku bënë pjesë persona të punësuar dhe të papunësuar, persona nga përkatësi të ndryshme etnike dhe persona nga të dy gjinitë. Nga pyetjet shumë domethënëse që përfshinte anketa, këtu do të veçojmë vetëm disa prej tyre. Pyetjes se çka paraqet për to korrupsioni, ata japin definicione të tilla si: padrejtësi,

shkatërrim i shoqërisë, marrje e parave ekstra, përfitim material, plagë për kombin, vjedhje, plaçkitje, mito, shkatërrim të institucioneve, diçka jo të ligjshme, keqpërdorim i një detyre (funksioni), manipulim, shitje e interesave kolektive për interesa personale, kushtëzim material, pasurim në shpinë të popullit...

Pyetjes tjetër "Te kush e shihni përgjegjësinë për çrrënjosjen e këtij problemi ", përqindjet ishin të ndara pothuajse njëjtë tek të trija opcionet e vendosura nga ne, si institucionet shtetërore, partitë politike dhe nga vetë populli.

Anti korrupsioni- Si të luftohet korrupsioni?

Të ndërtohen politika kundër korrupsionit, për vendet në tranzicion (siç jemi ne), ka rëndësi të veçantë. Ashtu siç është problematike vetë definimi i korrupsionit, ashtu është edhe formulimi i politikave në çdo shtet për ta luftuar atë.

Në një formë apo një tjetër, ne të gjithë bëhemi pjesë e korrupsionit. Pse të mos e luftojmë atë?!

Le të fillojë ndryshimi nga ty!



DITA E DALLIMEVE

Shkencëtari i madh Albert Ajnshtajn që zbuloi teorinë e relativitetit thoshte :1% intelecjençë e 99% punë. E nisa me këtë thënie duke menduar se do ti përshtatet aktivitetit në kuader të një agjende të përgaditur nga gjithë anëtarët dhe përkrahësit e organizatës tonë. Qëllimi final ishte që çdo gjë të dukej bukur e paksa “mahnitëse” në një këndvështrim të përgjithshëm, duke u munduar që çdonjëri me punën e vet të sjellë ndonjë risi që do t'i pëlqente publikut.

Teksa po bëheshin përgaditjet në Qendrën e Kulturës, secili kishte një detyrë të caktuar. Disa ishin të angazhuar të qëndrojnë tek ushqimet, disa shërbenin pije, e disa organizata tjera joqeveritare ishin të ftuar si mysafir, të cilët poashtu kishin përgatitur aktivitete të tyre.



Kur çdo gjë sinjalizonte të gjelbërtën, jashta po shihej një grumbull nxënësish, të cilët vinin nga shkolla të ndryshme. Disa ishin aty për të parë aktivitetin, disa për të bërë skena qesharake e disa të dobët e agresiv, të cilët dukeshin simpatik po ti vëreje nga një këndvështrim prej së largu.

Ishte kënaqësi për ne që ky manifestim të hapet nga violinisti i mirënjohur shqipëtar, Shkëlzen Pajaziti, duke na argëtuar me tingujt mahnitës të violinës së tij.



Fjalimi përshëndetës ishim ne, anëtarë të organizatës Multikultura dhe një përfaqësues i Komunës së Tetovës. Salla ishte e mbushur përplot me nxënës, studentë e prindër, madje nuk mungonin as duartrokitjet e publikut, të cilët sillnin një gjallëri të fuqishme optimiste!

Vallet! Kryesisht vallet ishin aktiviteti i parë, grupe të njohura shqipëtare dhe maqedone si Xheladin Zeqiri e Izvor, madje edhe valle rome nga grupi Pralipe, të cilët ndikuan që ky organizim multikulturor të arrijë shkallën e duhur të planifikuar që më parë.

Pas mbarimit të këtyre aktiviteteve, njerëzit mundeshin të provojnë ushqimet e përgatitura nga vetë nxënësit me iniciativë vullnetare, të shihnin piktura të ndryshme të bëra nga piktorë të rinj, publikime të disa fotografive të gatshme, etj.

E gjithë kjo që thash ishte njëra pjesë e organizimit, ndërsa pjesa tjetër kishte të bëjë me organizimin e një argëtimi për të rinjtë në ODA, me muzikë të gjallë nga një grup i ri muzikor nga Tetova, XXL Band.



Kjo fillonte në ora 20:00. Nga vet fakti se ishte ditë e premtë dhe të rinjtë kanë nevojë të argëtohen gjatë fundjavave. Të gjithë ishin të mirëseardhur në atë mbrëmje, veçanërisht ata, të cilët janë të dhënë pas qejfeve e argëtimeve... Atmosfera ishte në nivel, gjithçka dukej bukur, veçanërisht publiku, se vetem ai mund ta krijojë atmosferën, duke mos e përjashtuar edhe muzikën, edhe pse shpeshherë thonë "Atmosferën e bëjnë njerëzit".

Po afrohej fundi, ora ishte 23:05... Disa shkronin në shtëpi, disa qëndronin ende, madje disa u mbledhën në një tavolinë dhe kërkonin të këndojnë muzikë karaoke. Disa përshpërisnin me njëri tjetrin duke u ndjerë të lodhur, por të kënaqur nga mbrëmja ...

RINIA E UDHËHEQ ARDHMËRINË

Riniste – i them vetes, i them trupit, ndjenjës, fantazisë, mendimeve precise, katastrofës, lumturisë... Më lehtësoi, më ngjalli, m'i humbi ëndërrat e çdonatshme, m'a humbi fantazinë magjepsëse.

Rinia – koha ime që jetoj, e adhuroj, që u shfaq si një pasqyrë për të shijuar veten, vallë... ç'bëri? ...Humbi mendimet fëmijërore!

Ç'lodhe kokën! Shijoe botën! Pse rraskapitesh aq thellë?- më pyeste pasqyra e "Rinisë".

Oh, ç'më ndodh, pse erdhi koha që një pjesë të posaçme t'ja kushtoj mbretit të rinisë?

Vallë erdhi koha ta bëj hapin, të shkel pragun e mendimeve precise?

Je duke i hapur sytë në horizontin ku "ai" qëndron si artist renacak- thotë nëna, prandaj konsulltohu me mendimet, ngase është periudhë jetësore e cila udhëheq ardhmërinë, e udhëheq të ardhmen tënde.





Periudhë jetësore e cila nuk përfshin dekada e dekada, ngase jeta është e shkurtë, por përfshin periudhën më të ëmbël jetësore të njeriut mirëpo njëkohësisht në mënyrë paralele periudha jetësore ku njeriu duhet patur shumë kujdes, precizitet në çdo hap, besim dhe bindje në vete, analiza të mëdhaja në tru dhe konkludime të sakta e jo të gabueshme.

Periudhë e jetës, e cila të sjell ardhmëri, mirëpo e gjithë ajo ardhmëri varet nga punët e juaja, të cilat i bëni në kohë të rinisë, ngase vet periudha është e tillë që të bëni konfuzë, të bëni të dyshosh në vendimet të cilat duhet ti marrësh, sa here të çon të dyshosh në vete, por mbi të gjitha duhet të mbizotërojë karakteri i forte i joni, vendosshmëria dhe besimi në vete. Sepse, ne jemi vetë ata, të cilët duhet të dijmë se çfarë kërkojmë nga jeta dhe çfarë roli kemi ne në të, duhet të dijmë se çfarë presim ne nga vetja dhe çfarë idealesh kemi për veten tonë.

Të bëjmë të mundshmen ti arrijmë ato, të bëhemi një dritë që shëndrrit, por jo një dritë e thjeshtë, sepse çdokush shëndrrit në mënyrë të vete. Të bëhemi një dritë e veçantë, e cila e arrin të pamundurën, të bëhemi dikush në jetë që arrin të prosperoj dhe të jetë i respektuar, i nderuar dhe i veçantë ne sytë e njerëzve, pra të jetë dikush ne jetë.

Rini e gabuar, ardhmëri e palakueshme; ndërsa rini e saktë, e ëmbël, pa katastrofa të sjell një ardhmëri fatlume...





MULTIKULTURA

adresa: Jane Sandanski 48/1; (p.fah. 142); 1200 Tetovë, Maqedoni

Tel.: +389 44 522 355

e-mail: info@multikultura.org.mk

www.multikultura.org.mk

përkrahur nga:  Norwegian People's Aid